



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 785/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.11.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1534 prot., datë 27.09.2018 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF- 80581-07-25-2018, me objekt “Rikonstruksion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare “Hysi Malko”, fshati Kryekuq, Bashkia Divjakë”, me fond limit 34.711.140 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.08.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k.
Rruga “Stilian Thoma”, Kuçovë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Divjakë
Lagjia nr. 2

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF- 80581-07-25-2018, me objekt “Rikonstruksion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare “Hysi Malko”, fshati Kryekuq, Bashkia Divjakë”, me fond limit 34.711.140 (pa TVSH).

II.2. Në datën 27.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët, referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k.	23.000.000 lekë, skualifikuar
2. “Spektri” sh.p.k.	24.857.200 lekë, kualifikuar
3. “Llazo” sh.p.k.	25.818.574 lekë, skualifikuar
4. “Xhimo & Kleo” sh.p.k.	26.273.820 lekë, kualifikuar
5. “Jogi” sh.p.k.	26.407.460 lekë, kualifikuar
6. “B-93” sh.p.k.	26.481.255 lekë, kualifikuar
7. “Colombo” sh.p.k.	26.830.119 lekë, kualifikuar
8. “Mela” sh.p.k.	28.000.000 lekë, skualifikuar
9. “Zdravo” sh.p.k.	28.243.175 lekë, skualifikuar
10. “Bahar” sh.p.k.	28.610.100 lekë, kualifikuar

11. "Aurora Konstruksion" sh.p.k.	28.793.150 lekë, skualifikuar
12. "Leon Konstruksion" sh.p.k.	28.817.295 lekë, kualifikuar
13. "Shëndelli" sh.p.k.	30.102.368 lekë, skualifikuar
14. "Liqeni VII" sh.p.k.	30.776.220 lekë, kualifikuar
15. "Kacdedja" sh.p.k.	32.469.850 lekë, kualifikuar
16. "Kevin Konstruksion" sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
17. "Elda – VL" sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.3. Në datën 07.09.2018 operatori ekonomik "Shkëlqimi 07" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 13.09.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij.

II.5. Në datën 17.09.2018, me shkresën nr. 2959/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e marrë në konsideratë atë, ndërkohë që operatori ekonomik "Shkëlqimi 07" sh.p.k. pretendon se ka marrë dijeni për përgjigjen në datën 24.09.2018.

II.6. Në datën 27.09.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7. Në datën 09.10.2018 nëpërmjet shkresës me nr. 3258/1 prot., datë 08.10.2018, me objekt "*Dërgim informacioni*", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Shkëlqimi 07" sh.p.k.

II.8. Në datën 16.11.2018, operatori ekonomik "Shkëlqimi 07" sh.p.k. ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me nr. REF- 80581-07-25-2018, me objekt "*Rikonstruksion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare "Hysi Malko", fshati Kryekuq, Bashkia Divjakë*", me fond limit 34.711.140 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.08.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues "Shkëlqimi 07" sh.p.k. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me nr. REF- 80581-07-25-2018, me objekt "*Rikonstruksion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare "Hysi Malko", fshati Kryekuq, Bashkia Divjakë*", me fond limit 34.711.140 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.08.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1, parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 80581-07-25-2018, me objekt “*Rikonstruktion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare "Hysi Malko", fshati Kryekuq, Bashkia Divjakë*”, me fond limit 34.711.140 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.08.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1534 Protokolli;

Datë 27.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha